



Pranuar / Dorezuar Received/Received	10.01.2022	viti god year	2
Organ / Njësia Org / Unit	33/2022	Shtojta Prilog Appendix	1/4



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.962/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin e dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Malsore Gashi-Bajraktari, anëtare dhe Avdyll Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.962/2021 të datës 24.11.2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë rruga

kundër Vendimit me Nr.907 të datës 10.11.2021 të Kryetarit të Komunës së Gjilanit, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datë 10.01.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si bazuar ankesa me numër A.nr.962/2021 të datës 24.11.2021 të parashtruar nga ankuesi
- II. Shfuqizohet Vendimit me Nr.907 i datës 10.11.2021 i Kryetarit të Komunës së Gjilanit.
- III. Obligohet Kryetari i Komunës së Gjilanit dhe Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Gjilanit, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi të bëjë zbatimin e tij, duke bërë llogaritjen e ditëve të pushimit vjetor të pashfrytëzuara nga ankuesi, dhe të njëjtit t'i bëjë kompensimin për këto ditë në pajtim me legjislacionin në fuqi.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Komunën e Gjilanit, me datë 24.11.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 5636/2021, të regjistruar me numër A.nr.962/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.907 të datës 10.11.2021 të Kryetarit të Komunës së Gjilanit, me pretendimin ankimor për njohjen e të drejtës për kompensimin e pushimit vjetor të pashfrytëzuar me rastin e përfundimit të marrëdhënies së punës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 01.12.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Komunën e Gjilanit, ndërsa më datë 15.12.2021 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Gjilanit, me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, pas konstatimit të ankesa e parashtruar nga ankuesi është e pranueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, për vendosje meritore, administroj këto prova: Ankesën me numër protokoll 5636/2021, të regjistruar me numër A.nr.962/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr.907 të datës 10.11.2021 të Kryetarit të Komunës së Gjilanit; Formularin për kërkesë apo ankesë të datës 08.10.2021; Kërkesën e datës 06.10.2021 për kompensimin e ditëve të pa shfrytëzuara të pushimit vjetor për vitin 2021; Vërtetimin e datës 22.11.2021; Vendimin për përfundimin e marrëdhënies së punës të datës 24.09.2021; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 01.12.2021; Përgjigjen në ankesë të datës 15.12.2021 nga Komuna e Gjilanit; Akt Emërimit e datës 15.02.2012 të ankuesit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa A.nr.962/2021 e datës 24.11.2021 e parashtruar nga ankuesi, është e bazuar, sepse:

Bazuar në shkresat e lëndës, gjegjësisht Akt Emërimit e datës 15.02.2012 është konstatuar se ankuesi ka qenë i punësuar në Komunën e Gjilanit, në pozitën e punës "Zyrtar Juridik" në Sektorin e Pronës. Kryetar i Komunës së Gjilanit më datë 24.09.2021 ka nxjerr Vendim me Nr.734 për përfundimin e marrëdhënies së punës të ankuesit për shkak të arritjes së moshës së pensionimit, nga data 15.10.2021.

Me datë 06.10.2021, ankuesi i është drejtuar Zyrës së Personelit pranë Komunës së Gjilanit, me kërkesë për kompensimin e ditëve të pa shfrytëzuara të pushimit vjetor të vitit 2021. Kryetari i Komunës së Gjilanit më datë 10.11.2021 ka nxjerr Vendim me Nr.907 përmes të cilit ka refuzuar kërkesën e ankuesit, me arsyetimin se pagesa e pushimit vjetor të pashfrytëzuar mund të bëhet vetëm kur kemi ndërprerje të marrëdhënies së punës së nëpunësve civilë.

Ankuesi, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se Vendimi me Nr.907 i datës 10.11.2021 i Kryetarit të Komunës së Gjilanit, për mos njohjen e kompensimit të pushimit vjetor të pushfrytëzuar është në kundërshtim me legjislacionin aplikueshëm për Zyrtarët Publikë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke iu referuar provave të lëndës të dorëzuara nga palët në procedurë dhe provave shtesë të kërkuara nga organi i punësimit, ka konstatuar se ankuesi nuk është njoftuar gjashtë (6) muaj para datës së pensionimit, siç parashihet me neni 60 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se: *Nëpunësi civil informohet për përfundimin e marrëdhënies së punës për shkak të pensionimit gjashtë (6) muaj para datës së pensionimit, nga njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore të institucionit.*

Kolegji, po ashtu, gjatë shqyrtimit të shkresave të lëndës, ka gjetur Vërtetimin me numër reference 10-942/04-0138178/21 të datës 22.11.2021 të lëshuar nga Drejtori i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Gjilanit, ku thuhet se: *Zyrtar Juridik në Sektorin e Pronës të DGJKP-së, tani i pensionuar më datë 15.10.2021, nuk e ka shfrytëzuar asnjë ditë të pushimit vjetor 2021 për shkak të shtimit të numrit të madh të kërkesave në Drejtori dhe përfundimit të procedurave të shpronësimit për projektet komunale”,* kështu që duke u bazuar në këto prova, Kolegji, konstaton se organi i punësimit përveçse nuk e ka njoftuar ankuesin për datën e pensionimit siç përcaktohet me dispozitat ligjore në fuqi, të njëjtit për shkak të angazhimeve të shumta në drejtorinë përkatëse, nuk iu është mundësuar shfrytëzimi i pushimit vjetor të vitit 2021.

Duke iu referuar dispozitave të nenit 18 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Kolegji konstatoi se pushimet e zyrtarëve publikë rregullohen sipas legjislacionit të punës. Me dispozitat e Ligji Nr.03/L-212 të Punës, përkatësisht neni 38 paragrafi 1 përcaktohet se: *Të punësuarit nuk mund t'i mohohet e drejta në shfrytëzimin e pushimit vjetor, ndërsa me paragrafin 2 të këtij neni përcaktohet se: I punësuarit që nuk e ka shfrytëzuar pushimin vjetor apo një pjesë të pushimit me fajin e punëdhënësit, ka të drejtë për ta shfrytëzuar atë pushim gjatë periudhës vijuese e cila i konvenon punëmarrësit, apo kompensim me të holla.* Andaj, duke marr parasysh se ankuesit i ka përfunduar marrëdhënia e punës me datë 15.10.2021, dhe meqenëse i njëjti nuk ka mundur të shfrytëzojë pushimin vjetor për shkak të numrit të madh të kërkesave në drejtorinë përkatëse në kuadër të organit të punësimit, fakt ky i vërtetuar me shkresën e datës 22.11.2021 të lëshuar nga Drejtori i Drejtorisë për Gjeodezi pranë Komunës së Gjilanit, Kolegji vlerëson se ankuesi ka të drejtë në kompensimin e ditëve të pushimit vjetor të pushfrytëzuar siç parashihet me 32 paragrafi 5 të Ligji Nr.03/L-212 të Punës, ku përcaktohet se: *Ditët e pushfrytëzuara të pushimit vjetor nuk mund të kompensohen me para, përjashtimisht kjo mund të bëhet kur marrëdhënia e punës i skadon të punësuarit.*

Andaj, bazuar si me lartë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se Vendimi me Nr.907 i datës 10.11.2021 i Kryetarit të Komunës së Gjilanit, për refuzimin e kërkesës se ankuesit lidhur me kompensimin e pushimit vjetor të pushfrytëzuar, është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, dhe dispozitat e nenit 32 dhe 38 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, kështu që pretendimi ankimor i ankuesit në këtë kuptim është i bazuar.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se Kryetari i Komunës së Gjilanit, në rastin e ankuesit duhet të veprojë në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, duke ia kompensuar të njëjtit ditët e pashfrytëzuara të pushimit vjetor të vitit 2021.


Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.962/2021

Avdyl BEKTESHI


Procesmbajtës



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Gjilanit;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Gjilanit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

